
Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë* (PKEK)

Raporti fillestar

ECU/PECK-1/2012

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Emërtimi i projektit	Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PKEK)
Numrat e referencës	CRIS Nr. 2011/282-152 dhe KE Nr. JP/ 2590
Kohëzgjatja e projektit	30 muaj
Zbatimi	Drejtoria e përgjithshme për të drejta të njeriut dhe çështje ligjore, Këshilli i Evropës
Buxheti i projektit	1.200,000 EURO
Periudha raportuese	1 shkurt 2012 – 15 gusht 2012
Data e raportit	12.09.2012

Për informata të tjera luteni të kontaktoni: Njësia Kundër Krimet Ekonomik (NjKKE) Departamenti për aktivitetet kundër krimet Drejtoria e shoqërisë së informacionit dhe aktiviteteve kundër krimet Këshilli i Evropës, F- 67075 Strasbourg igor.nebyvaev@coe.int ; + 33 3 88 90 21 55 99	Ky raport është hartuar nga ekipi i projektit të PKEK-së. Pikëpamjet e shprehura në të në asnjë mënyrë nuk mund të pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe (apo) të Këshillit të Evropës.
Ekipi Projektit në Prishtinë Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë Rr. Bedri Pejani nr. 3 10000 Prishtinë, Kosovë Edmond Dunga Këshilltar i Projektit PECK Tel: +381 38 243 749 ext. 106 Fax: +381 38 243 752 Email: Edmond.dunga@coe.int Luljeta Plakolli Zyrtare Vendore e Projektit Tel: +381 38 243 749 ext.105 Fax: +381 38 243 752 Email: luljeta.plakolli@coe.int	Dy institucionet koordinuese vendore: Agjencioni kundër Korrupsionit (AKK) Rr. Nazim Gafurri street, nr.31 10000 Prishtinë, Kosovë Personi kontaktues: Blerim Kelmendi Tel: +381 38 518 907 Email: blerim.kelmendi@rks-gov.net Njësiti i Inteligjencës Financiare (NjIF) Rr. Eduard Lir Street 10000 Prishtinë, Kosovë Person Kontaktues: Labinot Preniqi Tel: +381 38 247 102 Email: labinot.preniqi@fic-kos.org

Tabela e përmbajtjes

1	HISTORIKU	5
1.1	VENDI DHE INSTITUCIONET PËRFITUESE.....	5
1.2	AUTORITETI KONTRAKTUES.....	5
1.3	ORGANIZATA ZBATUESE	5
2	PROJEKTI	5
2.1	OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM	5
2.2	QËLLIMI I PROJEKTIT.....	6
2.3	REZULTATET E PRITURA (RP)	6
3	GJENDJA NË KOSOVË	7
3.1	GJENDJA NË SEKTOR.....	7
3.2	POLITIKAT RREGULLATIVE/SEKTORIALE.....	8
3.3	NDIHESA TEKNIKE E DONATORËVE NDËRKOMBËTARË	11
3.4	NEVOJAT E TANISHME.....	12
4	PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE/QËLLIMEVE TË PROJEKTIT.....	13
4.1	AKTIVITETET.....	13
4.2	INPUTET	16
4.3	REZULTATET.....	16
5	AKTIVITETET E FILLIMIT.....	17
5.1	PËRMBLEDHJE E VEPRIMEVE.....	17
5.1	KRIJIMI I EKIPIT TË PROJEKTIT/REKRUTIMI	17
5.2	ZYRA/MJEDISËT E PROJEKTIT	18
5.3	AKTIVITETET FILLESTARE – FAZA I (14-16 SHKURT 2012).....	18
5.4	AKTIVITETET FILLESTARE – FAZA II (28-29 MARS 2012).....	18
5.5	FILLIMI I PROJEKTIT – FAZA III (25-26 PRILL 2012)	19
6	DUKSHMËRIA/MBULIMI MEDIAL	21
6.1	FAQJA E INTERNETIT E PKEK-SË.....	21
6.2	DUKSHMËRIA E BE-SË	21
6.3	MOHIM	21
	PUBLIKIMET	21
7	BUXHETI DHE KONTRIBUTET.....	21
8	HAPAT E ARDHSHËM DHE PËRFUNDIMET	22
8.1	HAPAT E ARDHSHËM.....	22
8.2	NDIKIMI AFATGJATË I PROJEKTIT	22
8.3	KOMISIONI DREJTUES DHE KOORDINATORËT E PROJEKTIT	22
8.4	RREZIQET E MUNDSHME.....	22
8.5	PËRFUNDIMET	23
9	LISTA E SHTOJCAVE.....	24

1 HISTORIKU

Projekti kundër Krimin Ekonomik në Kosovë (PKEK) ka filluar më 1 shkurt 2012. Ky raport fillestar paraqet aktivitetet dhe gjendjen e projektit gjatë kësaj faze, e cila paraqet përgatitjet për fillimin e zbatimit të aktiviteteve të projektit. Faza fillestare ka përfunduar formalisht më 30 prill 2012.

1.1 Vendi dhe institucionet përfituese

Përfituesi: Kosova

Institucionet kryesore përfituese: Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës (AKKK), Njësi i Inteligjencës Financiare (FIU), dhe Zyra për Qeverisje të Mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Përfituesit e projektit në mes të tjerash përfshijnë agjencitë vijuese kryesore në Kosovë në fushën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave, si dhe të luftimit të financimit të terrorizimit:

- Zyrën e Prokurorit Special të Kosovës (ZPSK);
- Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK);
- Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK);
- Policinë e Kosovës (PK);
- Inspektorati i Policisë të Kosovës (IPK);
- Ministrinë e Drejtësisë (MD);
- Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB);
- Ministrinë e Financave (MF);
- Ministrinë e Administratës Publike (MAP);
- Bankën Qendrore të Kosovës (BQK);
- Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës (AIK);
- Agjencinë për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AMPSK);
- Doganën e Kosovës (DK);
- Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP);
- Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP);
- Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRrPP);
- Agjencionin Qendror të Prokurimit (AQP);
- Kuvendin e Kosovës (KK);
- Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ);
- Avokatin e Popullit të Kosovës;
- Agjencinë për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës (ARBK)

1.2 Autoriteti kontraktues

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

1.3 Organizata zbatuese

Këshilli i Evropës është përgjegjës për zbatimin e projektit dhe për shfrytëzimin e fondeve të projektit sipas marrëveshjes së Komunitetit Evropian me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në kuadër të Sekretarisë së përgjithshme të Këshillit të Evropës në Strasburg, Drejtoria e përgjithshme për të drejta të njeriut dhe çështje ligjore, Drejtoria për shoqërinë e informacionit dhe aktivitetet kundër krimit, dhe më konkretisht, Departamenti për aktivitetet kundër krimit, gjegjësisht Njësia kundër krimit ekonomik do të jenë struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të projektit. Ekipi i projektit me seli në Prishtinë, i përkrahur nga Njësia kundër krimit ekonomik, e vendosur në selinë e Këshillit të Evropës, do të jenë përgjegjës për realizimin e përditshëm të këtij projekti.

2 PROJEKTI

2.1 Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i PKEK-së është dhënia e kontributit për demokraci dhe sundim të ligjit përmes parandalimit të korrupsionit, të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit në Kosovë.

2.2 Qëllimi i projektit

Të fuqizohen kapacitetet institucionale për luftimin e korrupsionit, të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane përmes vlerësimit të thukhtë dhe rekomandimeve për përmirësimin dhe orientimin e duhur të reformës në fushën e luftimit të krimit ekonomik.

2.3 Rezultatet e Pritura (RP)

Në vijim janë paraqitur rezultatet e pritura të projektit. Arritja e tyre do të çojë në realizmin e qëllimit të projektit dhe do t'i kontribuojë objektivit të përgjithshëm.

Përkritazi me komponentin kundër korrupsionit:

RP 1.1 Ekzistimi i raporteve lidhur me nivelin e përputhshmërisë të rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (bazuar në përvojën dhe kriteret të zbatuara nga GRECO dhe nga organet e tjera relevante të Këshillit të Evropës);

RP 1.2 Aftësimi i institucioneve të Kosovës për përkrahjen dhe për zbatimin e vlerësimit të kolegëve ekspertë për masat kundër korrupsionit, duke u bazuar në metodologjinë evropiane të monitorimit;

RP 1.3 Ekzistimi i rekomandimeve për fushat rregullative, institucionale dhe të politikave;

RP 1.4 Publikimi dhe shpërndarja e raporteve të vlerësimit dhe të progresit (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Lidhur me komponentin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit:

RP 2.1 Ekzistimi i raporteve të vlerësimit për nivelin e përputhshmërisë së rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (duke u bazuar në përvojën dhe kriteret e MONEYVAL-it dhe të organeve të tjera përkatëse ndërkombëtare);

RP 2.2 Aftësimi i institucioneve të Kosovës që të përkrahin dhe zbatojnë vlerësimet e kolegëve ekspertë në fushën e masave financiare kundër pastrimit të parave dhe në atë të luftimit të terrorizimit, duke u bazuar në metodologjinë evropiane të mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë të vlerësimit;

RP 2.3 Dhënia e rekomandimeve për fushat rregullative, institucionale dhe të politikave;

RP 2.4 Publikimi dhe shpërndarja e raporteve të vlerësimit dhe të progresit (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

3.1 Gjendja në sektor

Korrupsioni mbetet sfidë serioze për Kosovën. Sipas një ankete të bërë nga Instituti Demokratik i Kosovës, që ishte bazë e Barometrit global të korrupsionit të vitit 2010, të hartuar nga Transparency International¹, 73% e të anketuarve në Kosovë mendojnë se që nga viti 2007 niveli i korrupsionit është rritur, ndërsa vetëm 8% mendojnë se korrupsioni ka rënë; 61% e të anketuarve mendojnë se masat kundër korrupsionit nuk kanë pasur ndonjë efekt, ndërsa vetëm 8% mendojnë se korrupsioni ka rënë; 16% kanë dhënë ryshfet për kryerjen e ndonjë shërbimi së paku njërit prej nëntë ofruesve të ndryshëm të shërbimeve në 12 muajt e kaluar.

Sipas indeksit për perceptimin e korrupsionit të Transparency International për vitin 2011, Kosova shënon shkallën 2.9 (ku shkalla 112 paraqet nivelin më të ulët të korrupsionit), që njëherësh paraqet rangun më të ulët në Ballkan.²

Në bazë të treguesve mbarëbotëror të Bankës Botërore për qeverisje, që nga viti 2003 kontrolli i korrupsionit në Kosovë ka treguar përmirësime të vogla, dhe ende mbetet i dobët, diku rreth 30% (100% paraqet kontroll të plotë të korrupsionit), me një tendencë të paqartë që nga viti 2005.³

Sipas renditjes së Nation in Transit të Freedom House po ashtu shihet se nuk ka përmirësime relevante që nga vlerësimi i parë në vitin 2004.⁴

“Vlerësimi i Kosovës (sipas RKS KB 1244/99) 2010”⁵, i hartuar nga projekti “Përkrahje për përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit” (SIGMA) i OBEZH-it dhe BE-së tregon se “perceptimi i niveleve të larta të korrupsionit në të gjithë sektorët” është një nga faktorët kryesorë që çojnë në “konkludimin se ende nevojiten përpjekje domethënëse për sigurimin e sundimit të ligjit në Kosovë.”. Në raport theksohet se “përzierja e kompetencave dhe bashkëpunimi i dobët mes institucioneve të ndryshme (AKKK [Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës], Zyra e Prokurorit Publik, Zyra për Qeverisje të Mirë, Këshilli kundër korrupsionit, Policia) dhe kapaciteti i dobët i zbatimit janë ndër dobësitë e pranishme.” Raporti i vlerësimit 2011 e thekson mungesën e rezultateve të qarta dhe të dukshme në luftimin e korrupsionit që krijonë brenga në lidhje me kapacitetin e absorbimit të legjislacionit, përkushtimin e vërtetë në implementimin e tij dhe kapacitetin e institucionit dhe personelit.

Raporti i 30 qershor 2011 i Institutit Demokratik të Kosovës i quajtur “Kushtet e BE-së për luftimin e korrupsionit: Matja e përparimit në Kosovë”⁶ i numëron fushat e ndryshme ku ka nevojë për angazhim, siç është liria e informatës, monitorimi dhe verifikimi i deklaratimit të pasurisë, hartimi dhe zbatimi i kodeve të mirësjelljes, eliminimi i ndërhyrjeve politike, procedurat e drejta të punësimit dhe mbrojtja e informatorëve.

Anketa të shumta të opinionit publik dhe të ekspertëve, të realizuara nga Transparency International, duke përfshirë Barometrin global të korrupsionit, theksojnë se partitë politike në Ballkanin perëndimor perceptohen të jenë më të prekura nga korrupsioni.⁷ Raporti i Transparency International për financimin e partive politike nënvizon se partitë politike në Kosovë nuk kërkohet të kenë një llogari të vetme bankare për pranimin dhe shpenzimin e fondeve, dhe legjislacioni nuk ndalon depozitat në para të gatshme.⁸ Legjislacioni ekzistues nuk përcakton qartazi afatet kohore dhe mekanizmat e publikimit të raporteve financiare të partive, gjë që parqet pengesë për zbatimin e dispozitave për transparencë.⁹

Sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka raportuar se Misioni i tyre deri më tani ka shqiptuar dënimin për 15 raste të korrupsionit, ku disa prej tyre kanë qenë raste të nivelit të lartë, por asnjë pronë e fituar në mënyrë të paligjshme në asnjërin prej këtyre rasteve nuk është konfiskuar.¹⁰ Kjo ka ndodhur me siguri për shkak të “kapaciteteve të kufizuara apo të dobëta, qoftë në aspektin juridik,

¹ www.transparency.org

² <http://cpi.transparency.org/cpi2011/results/>

³ Banka Botërore, <http://info.worldbank.org/governance/wgi/>

⁴ Sipas vlerësimit të bazuar në shkallën prej 1-7, ku 1 paraqet nivelin më të lartë të progresit, prej vitit 2004 deri në vitin 2007 Kosova ka qenë e renditur në vendin, ndërsa prej vitit 2008-2011 në vendin 5.75 <http://www.freedomhouse.org>

⁵ www.sigmaweb.org/dataoecd.28/41/46401972.pdf, në f.3

⁶ www.kdi-kosova.org/publications.rn_kbkk.pdf

⁷ Transparency International, “Shining a light on Political Party Financing: Albania, Croatia, Kosovo, FYR Macedonia and Serbia 2011, f.2.

⁸ Transparency International, note 8, f. 6.

⁹ Po aty. f. 15.

¹⁰ Instituti i Kosovës për Hulumtime të Politikave dhe Zhvillim (KIPRED), Dokument i politikës 2011/05, “Fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë II: Konfiskimi i pronës së fituar në mënyrë të paligjshme”, Prishtinë, prill 2011, f.5.

ashtu edhe në atë institucional, për konfiskimin e pronës së fituar në mënyrë të paligjshme”, siç është vlerësuar në maj të vitit 2011 nga Instituti Demokratik për Hulumtime të Politikave dhe Zhvillim i Kosovës.¹¹

Lidhur me fushën kundër pastrimit të parave dhe atë luftimit të financimit të terrorizimit, nuk ka të dhëna statistikore në Kosovë në lidhje me madhësinë dhe shtrirjen e rrezikut. Nuk prodhohen raporte vjetore nga autoritetet kompetente dhe nuk ka të dhëna të publikuara për publikun më të gjërë¹². Njëkohësisht, sasia dhe cilësia e të dhënave nga autoritetet për zbatimin e ligjit dhe nga ato gjyqësore në të kaluarën është konsideruar si e pamjaftueshme për të vlerësuar numrin dhe karakteristikat e krimeve të pastrimit të parave të hetuara, të ndjekura penalisht dhe të përpunuara nga gjykatat.¹³

Megjithatë, shkalla e pastrimit të parave është e ndërlidhur me nivelin e ekonomisë së hirtë (kontrabandën me drogë, prostitucionin, kontrabandën e mallrave të paligjshme, falsifikimin dhe piratërinë dhe aktivitete të tjera kriminale, duke mos përfshirë këtu shmangien e tatimeve, si pjesë të ekonomisë së hirtë). Në vitin 2007 në Kosovë, niveli i ekonomisë së hirtë gjatë periudhës 2004-2006 në shkallë vjetore është vlerësuar të jetë më shumë se 300 milionë euro. Në bazë të raportit të fundit të Europolit për “Vlerësimin e kërcënimit të krimit për vitin 2011”, i cili raport është organizuar nga BE-ja, Kosova është ende rajon me organizata me aktivitet të lartë kriminal, posaçërisht në fushën e trafikimit të drogës dhe të armëve.¹⁴ Të hyrat nga këto aktivitete kriminale kalojnë nëpër pastrim të parave.

Andaj, nuk është befasi se më shumë se 420.000 transaksione të parave të gatshme (mbi 10 000 euro) janë raportuar në vit tek NjIF, një numër ky shumë i lartë nëse e krahasojmë me numrin e popullsisë në Kosovë dhe me ekonominë e saj. Në të njëjtën kohë, NjIF-i gjithashtu raporton se i ka pranuar disa transaksione të dyshimta lidhur me financimin e terrorizimit.

Vlerësimet e fundit të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit në Kosovë vazhdimisht kanë theksuar nevojën për reforma të gjëra legjislative dhe organizative në mënyrë që Kosova të jetë në harmoni me standardet evropiane dhe ato botërore.¹⁵

Në takimet me të gjitha institucionet homologe që u organizuan gjatë realizimit të aktiviteteve nismëtare edhe njëherë u vërtetua që Kosova ka nevojë për përkrahje të fuqishme në rritjen e kapaciteteve të saj legjislative dhe institucionale për luftimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe për luftimin e financimit të terrorizimit. Kjo pritjet të arrihet përmes vlerësimit të masave ekzistuese dhe të dhënies së rekomandimeve për afat të shkurtër, të mesëm dhe për afat të gjatë autoriteteve të Kosovës lidhur me mënyrën e përmirësimit të kapaciteteve ekzistuese dhe të zbatimit të efektshëm të legjislacionit në praktikë.

3.2 Politikat rregullative/sectoriale

Luftimi i korrupsionit

Në muajt e fundit janë miratuar ligje dhe amendamente të rëndësishme të tyre, përmes të cilave janë futur disa dispozita të nevojshme, të cilat rrjedhimisht do të mund të ishin mekanizëm i rëndësishëm për luftimin e krimit ekonomik, përfshirë këtu:

- Kodin Penal (Ligji Nr. 04/L-082 i 20 prill 2012);
- Ligjin “mbi Policinë” (Ligji Nr. 04/L-076 i 23 janarit 2012);
- Ligjin “mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pronës të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe mbi Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave të të gjithë shërbyesve civil”, (Ligji Nr. 04/L-050 i 31 gusht 2011);
- Ligji “mbi parandalimin e konfliktit të interesit në shkarkimin e funksioneve publike” (Ligji Nr. 04/L-051 i 31 gusht 2011);
- Ligji “mbi Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale” (Ligji Nr. 04/L-030 i 31 gusht, 2011);
- Ligji “mbi Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale” (Ligji Nr. 04/L-031 i 31 gusht, 2011);
- Ligji “mbi Prokurimin Publik” (Ligji Nr. 04/L-042 i 31 gusht, 2011);
- Ligji “mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve” (Ligji Nr. 04/L-015 i 29 korrik, 2011);
- Ligji “mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare” (Ligji Nr. 03/L-215 i 7 tetor 2010);
- Ligji “mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligji Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin dhe Përgjegjësinë Publike Financiare” (Ligji Nr 03/L-221 i 12 korrik, 2010);
- Ligji “mbi Avokatin e Popullit” (Ligji Nr. 03/L-195 i 22 korrik 2010);
- Ligji “mbi Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar” (Ligji Nr. 03/L-159 i 29 dhjetor 2009);

¹¹ KIPRED, pika 11, në f. 23.

¹² UNOCD, “Raporti i Vlerësimit Teknik”, prill 2010

¹³ B&S Evropa 2007 “Anketë për shkallën dhe parandalimin e ekonomisë së paligjshme dhe të pastrimit të parave në Kosovë. Raport i përgatitur për Agjencinë Evropiane për Rindërtim”, f. 21.

www.eulex-kosovo.eu/training/police/PoliceTraining/ORGANIZED_CRIME/DOCUMENTS/2.pdf.

¹⁴ www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/octa_2011.pdf.

¹⁵ Departamenti Amerikan i Shtetit, “Raporti për strategjinë ndërkombëtare të kontrollit të narkotikëve, vëllimi II, Pastrimi i parave dhe krimet financiare”, mars 2011, f. 46.

Mbetet të vlerësohet nëse korniza ligjore kundër korrupsionit dhe zbatimi i saj plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe ato Evropiane. Korniza legjislativë dhe rregullative, edhe pse shumë shpesh e ndryshuar, ende parasheh futjen e procesit në një rrjedhë të vetme, por në disa fusha ka ende dykuptimësi. Disa ligje/ndryshime relevante në fushën e luftimit të korrupsionit tani për tani janë në procesin parlamentar ose qeveritar, gjegjësisht:

- Draftkodi i Procedurës Penale (04/L-123)- leximi i parë është bërë në Kuvend në qershor 2011;
- Draftligji mbi “ kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar përmes veprës penale”, i cili ndodhet ende në procedura qeveritare.

Me 11 janar 2012, autoritete e Kosovës miratuan **Strategjinë kundër korrupsionit dhe Planin e veprimit kundër korrupsionit për vitet 2012-2016**. Këto dokumente janë shqyrtuar nga Kuvendi i Kosovës në leximin e parë, më 19 prill 2012, dhe ende pritet miratimi i tyre përfundimtar.

Sa i përket kornizës institucionale, Zyra për Qeverisje të Mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka rolin kryesor për çështjet e ndërlidhura me qeverisjen e mirë, ku, në mes të tjerash, përfshihen edhe politikat kundër korrupsionit. Përveç Grupit punues ndërmënor kundër korrupsionit që udhëheqë, kjo Zyrë merr pjesë në bashkërendimin dhe monitorimin e politikës kundër korrupsionit në të gjithë sektorët.

Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës (AKKK) është organi kryesor operacional për politikat kundër korrupsionit dhe për mbikëqyrje. Kjo Agjenci është themeluar në vitin 2006, dhe ka arritur të rrisë e të fuqizojë disa kapacitete, dhe para ca kohësh ka filluar të funksionojë sipas Ligjit të ri të ndryshuar për Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës.¹⁶ Sipas nenit 3 të Ligjit, Agjencia “është organ i pavarur dhe i specializuar që është përgjegjës në zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë”.

Sa i përket zbatimit të ligjit dhe prokurorisë, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës (ZPSK) është themeluar në shkurt të vitit 2010. Detyra kryesore e ZPSK-së është trajtimi i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Sot, një e treta e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, me të cilat merret ZPSK-ja, ekskluzivisht u jepen prokurorëve vendorë të Kosovës, edhe pse hetimet më të ndjeshme ende janë nën kompetencë të prokurorëve ndërkombëtarë, të emëruar nga EULEX-i.¹⁷

Përkritazi me parandalimin e korrupsionit në gjyqësor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/52 për themelimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe aktualisht bazohet në Ligjin e vitit 2008 për përbërjen e përkohshme të KGJK-së dhe në Ligjin nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të datës 3 nëntor 2010. Këshilli siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor. Është përgjegjës për punësimin dhe për propozimin e kandidatëve për emërim në poste gjyqësore.¹⁸ Këshilli është po ashtu përgjegjës për transferin e gjyqtarëve dhe për procedurat disiplinore. Në kuadër të KGJK-së, Zyra e Këshillit disiplinor është organi përgjegjës për trajtimin e pretendimeve për korrupsion dhe keqsjellje në gjyqësor.¹⁹ Megjithatë, hetimet e duhura në këtë fushë raportohet të kenë munguar.²⁰ Ekziston edhe organi i barasvlershëm për prokurorët e Kosovës, i quajtur Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK). KPK-ja është institucion i pavarur, përmes të cilit sigurohet qasja e barabartë në drejtësi, si dhe një punë e pavarur, profesionale dhe e paanshme e prokurorëve.²¹

Tridhjetë (30) hetues të Policisë së Kosovës (PK) janë pjesë e Grupit veprues kundër korrupsionit të ZPSK-së. Po ashtu, PK-ja ka themeluar Drejtorinë kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit. Drejtoria e sapoformuar ende sfidohet nga mungesa e pajisjeve dhe punonjësve të duhur. Ankesat gjithashtu janë ngritur lidhur me ristrukturimin e brendshëm dhe avancimin në punë në KP, të cilat pretendohet se janë të bazuara në preferenca politike dhe jo në përvojë profesionale apo në efektshmëri në punë.²² Kapacitetet në hetimet e udhëhequra nga informatat, hetimet proaktive dhe operacionet e fshehta duket se ende janë të kufizuara.²³ Bashkërendimi mes gjyqësorit dhe PK-së është përshkruar si “problematik”.²⁴ Policët e EULEX-it angazhohen së bashku me kolegët e tyre nga PK-ja, por policët e EULEX-it kryesisht kanë rol përkrahës, ndërsa PK-ja udhëheq operacionet.²⁵

PK-ja mbikëqyret nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Në kuadër të MPB-së, Inspektorati i Policisë së Kosovës është themeluar si organ ekzekutiv. Inspektorati i Policisë përbehet prej drejtorit ekzekutiv dhe inspektorëve, të cilët janë zyrtarë civilë dhe janë të pavarur nga Policia e Kosovës. Detyra e tyre është inspektimi i njërive policore, intervistimi i

¹⁶ Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës, i shpallur më 19 janar 2010.

¹⁷ www.eulex-kosovo.eu/en/news/000218.php

¹⁸ www.kgjk-ks.org/?cid=2,1.

¹⁹ www.kgjk-ks.org/?cid=2%2C152

²⁰ Freedom House, po aty.

²¹ www.md-ks.org/?page=2,83,320.

²² KIPRED, po aty.

²³ KIPRED, po aty.

²⁴ www.sigmaweb.org/dataoecd/28/41/46401972.pdf, at p.3.

²⁵ www.eulex-kosovo.eu/en/police/.

policëve, grumbullimi i të dhënave për realizimin e detyrave dhe hetimi i sjelljeve të këqija, duke përfshirë pretendimet për korrupsion. Drejtori ekzekutiv i Inspektoratit i përgjigjet MPB-së.²⁶ Përveç mbikëqyrjes së PK-së, MPB-ja udhëheq me sigurinë e brendshme në Kosovë në përgjithësi dhe, rrjedhimisht, edhe me luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AMPSK) është themeluar në qershor të vitit 2010 në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, pas shpalljes së Ligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Mandati i AMPSK-së është tërësisht administrativ, ku në mesin e përgjegjësisë të tjera përfshihen edhe si në vijim: menaxhimi, administrimi dhe (apo) shitja e pasurisë së konfiskuar. Edhe pse AMPSK-ja është funksionale që më shumë se një vit, ajo prapë se prapë paraqet një strukturë që ka nevojë për kapacitete dhe aftësi të specializuara për trajtimin dhe menaxhimin e rasteve të pasurive të konfiskuara dhe (apo) të sekuestruara, si dhe për avancimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera që janë relevante për punën e saj. Për shembull, që nga themelimi i saj e deri më sot, AMPSK-ja ia ka dalë të trajtojë vetëm një numër të vogël rastesh të pronës së sekuestruar, njëri prej të cilëve kishte të bënte me bagëtinë, i cili rezultoi të jetë i vështirë për shkak të vet natyrës së rastit dhe mungesës së mekanizmave për raste të tilla. Në qershor të vitit 2011, EULEX-i ka filluar një program 12-mujor aftësimi dhe të punësive për gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit e Kosovës, si dhe ata të EULEX-it lidhur me konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.²⁷

Ndihma ndërkombëtare e ndërsjellë juridike mbetet problematike për shkak të çështjes së statusit të Kosovës: Kosova nuk është nënshkruese e Konventës për ndihmë të ndërsjellë juridike për raste penale (ETS 30). Disa shtete evropiane bashkëpunojnë me Kosovën sipas parimit *ad hoc*, ndërsa disa të tjera nuk bashkëpunojnë. Jashtë Evropës, bashkëpunimi me autoritete e sundimit të ligjit dhe me gjyqësorin është i vogël. Mungesa e bashkëpunimit ndërkombëtar nga shtetet e huaja shkon në dëm të ndjekjes penale të krimeve në Kosovë dhe në këto shtete.

Luftimi i pastrimit të parave dhe i financimit të terrorizimit (LPP/FT)

Lidhur me luftimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit, ende nuk ekziston një dokument zyrtar strategjik që do të parashihte masat në këtë fushë. Sa i përket legjislacionit, deri në vitin 2010 sistemi është bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut²⁸. Ligji i ri për luftimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit është miratuar nga Kuvendi më 30 shtator 2010 (Ligji Nr. 03/L-196 “mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”), dhe është shpallur përmes Dekretit nr. DL-055-2010 të kryetarit, në tetor të vitit 2010. Propozimligjet e mëhershme janë përkrahur fuqishëm përmes këshillave teknike nga EULEX-i, dhe janë rishikuar dy herë nga Këshilli i Evropës, për të siguruar përputhshmërinë e Ligjit me standardet evropiane. Megjithatë, ligji, në versionin e tij të adoptuar është kritikuar si i mangët nga shumë palë me interes të përfshirë në hetime financiare. Gabimet përfshijnë, në mes tjerash, gabimet teknike në referencat e neneve kryesore, gjë që çon në pyetjet rreth bazë ligjore të disa normave. Ligji tani për tani është në shqyrtim, dhe pritet të dorëzohet për miratim gjatë verës së vitit 2012. Aktet nënligjore janë shqyrtuar vetëm pjesërisht, dhe pjesa më e madhe e tyre ende pritet të miratohen.

Zhvillimet më të fundit ligjore të rëndësishme përfshijnë adoptimin e ligjeve si në vijim²⁹:

- Ligjin “mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare” (Ligji Nr. 04/L-093 i 12 prill 2012) që përfshinë një numër të madhë të dispozitave të rëndësishme rregullative me rëndësi për kornizën LPP/FT);
- Ligji “mbi Lojërat e Fatit” (Ligji Nr. 04/L-080 i 6 prill 2012);
- Ligji “mbi Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare” (Ligji Nr. 04/L-057 i 29 gusht 2011);
- Ligji “mbi Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 mbi Organizimin e Bizneseve” (Ligji Nr. 04/L-006 i 23 qershor 2011);
- Ligji “mbi Bankën Qëndrore Kosovës” (Ligji Nr. 03/L-209 i 12 korrik 2010).

Qendra e Inteligjencës Financiare (QIF), si ish autoritet kompetent për të grumbulluar, analizuar dhe shpërndarë të dhëna të inteligjencës financiare, ia ka transferuar këto kompetenca në qershor 2012, Njësitit për Inteligjencë Financiare (NjIF), i cili është tash kompetentë për akumulimin, analizimin dhe transferimin e raporteve në lidhje me transaksionet e dyshimta organeve të zbatimit të ligjit në mënyrë që ta parandalojë pastrimin e parave (dhe shkeljet e ngjashme) dhe financimin e terrorizmit. NjIF mban baza të të dhënave të të gjitha raporteve të transaksioneve me para në dorë dhe raporteve të aktiviteteve të dyshuara dhe të të gjitha të dhënave dhe informacioneve të grumbulluara gjatë kryerjes së analizës të raporteve të tilla. Për më tepër, NjIF i shpërndan të dhënat dhe informacionet e inteligjencës tek organet e zbatimit të ligjit në Kosovë (Policisë, Administratës Tatimore, Bankës Qëndrore, Doganave etj.), organeve dhe entiteteve ndërkombëtare në Kosovë (EULEX-it, KFOR-it, etj.) dhe njësive të tjera të inteligjencës financiare jashtë vendit. NjIF-i nuk bën hetime penale, por organeve të tjera hetuese u ofron inteligjencë/informata që do të përdoren për fillimin e hetimeve penale apo për

²⁶ www.mpb-ks.org/?page=2,12

²⁷ www.eulex-kosovo.eu/en/news/000304.php.

²⁸ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/42, e 30 gushtit 2005, për ndryshimin e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2, për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave të ndërlidhura penale.

²⁹ Shih po ashtu disa ligje relevante të përmendura në komponentën e luftimit të korrupsionit (fq.8-9 më lartë)

vazhdimin e tyre.³⁰ Megjithatë, rrallë ndodh që NjIf të merr ndonjë informatë rreth rezultatit të hetimeve. NjIf-i ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi (MM) me vendet fqinje (përafërsisht 7 MM³¹) dhe po kështu ka krijuar kanale të komunikimit elektronik për këmbimin e kërkesave me Shqipërinë dhe Malin e Zi (përmes kanaleve të sigurta të koduara). Bashkëpunimi me vendet e tjera në rastin më të mirë është i pabarabartë për shkak të gjendjes së statusit: disa njësi të inteligjencës financiare të Evropë deri më tani nuk i janë përgjigjur qoftë inteligjencës për transaksione të dyshimta, të dhënë nga NjIf-i apo ndaj kërkesave për informata. Kjo mungesë e bashkëpunimit me siguri se shkakton pengesa serioze në zbatimin e ligjit në Kosovë dhe në vendet evropiane. NjIf-i vazhdimisht aftëson institucionet financiare për obligimet e tyre, por nuk ka fare kapacitete për vizita në teren për të parë përmbushjen e tyre në sektorin jo-bankar, aty ku është përcaktuar si mbikqyrës i dezignuar. NjIf e ka ende prezencën ndërkombëtare, dhe më saktësisht 3 këshilltar i EULEX-it.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK)³² është mbikëqyrëse dhe rregulluese e institucioneve financiare në Kosovë. Në Kosovë nuk ekziston tregu i kapitalit. Të gjitha bankat janë kryesisht banka komerciale, dhe 80% e tyre janë në pronësi të institucioneve të huaja financiare. Edhe pse Kosova kryesisht ka një ekonomi të parave të gatshme, besimi në sistemin bankar po shënon rritje sistematike rreth 2 % në vit. Raportohet se të gjitha bankat kanë zyrtarët e pajtueshmërisë. Përveç kësaj, BQK-ja ka një MM me NjIf-in për këmbimin e informatave lidhur me çfarëdo aktiviteti të dyshimtë brenda institucioneve financiare. Ky MM është zbatuar në shumë raste pas zbulimit të aktiviteteve të dyshimta. Kompanitë e sigurimit nuk kanë zyrtarë të pajtueshmërisë. Tregu i sigurimeve kryesisht është i orientuar në sigurimet e automjeteve motorike (rreth 74% e të gjitha policave të sigurimit janë sigurime të automjeteve), megjithatë ende nuk është marrë ndonjë informatë për madhësinë e sektorit të sigurimit të jetës, si dhe të produkteve të tjera të sigurimit të ndërlidhura me investime, të cilat bartin rrezikun e pastrimit të parave. Fondet pensionale janë prekur nga kriza financiare (10.4% rënie në vlerën e pasurisë së përgjithshme) pasi që ato kryesisht investojnë në tregje ndërkombëtare (95%), megjithatë, vlera e përgjithshme e pasurisë po shënon ngritje pasi që tregjet janë duke u rimëkëmbur. Sipas BQK-së, rreziqet kryesore të pastrimit të parave duhet të kërkohen në sektorin joformal. Donatorët ndërkombëtarë kanë organizuar aktivitete të trajnimit për punonjësit e BQK-së dhe për zyrtarët e pajtueshmërisë, ku disa prej tyre janë organizuar së bashku me punonjësit e NjIf-it dhe (apo) të policisë.

Njësi të Inteligjencës Financiare ndër Drejtoratin për Hetime të Krimit të Organizuar është përgjegjës vetëm për të ashtuquajtur raste të integruara (raste financiare të lidhura ngushtë me krimin e organizuar), por jo edhe për raste të pavarura të krimeve financiare. Drejtorati për Krime Ekonomike dhe Korrupsionin në Policinë së Kosovës (DKEK) dhe task forca kundër korrupsionit e themeluar rishtazi, e mbikqyrur nga Zyra e Prokurorit Special (PSRK-TFKK) merret me të gjitha llojet e krimeve financiare. DKEK merret rregullisht me krime financiare dhe raste të pastrimit të parave dhe PSRK-TFKK fokusohet në krime të profilit të lartë dhe të ndërlikuara³³.

Kosova është anëtare e Bankës Botërore (BB) dhe e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) që nga qershori i vitit 2009. NjIf i Kosovës është duke e konsideruar seriozisht anëtarësimin e ardhshëm në Grupin Egmont që përfshin gjithsejtë 106 anëtarë (Njësitë të Inteligjencës Financiare). Kosova nuk është anëtare e Grupit Veprues për Veprime Financiare (FATF) ose e ndonjë organi regional të llojit të FATF-së (p.sh.: MONEYVAL).

3.3 Asistenca e ngjashme teknike nga donatorët ndërkombëtar

Në fushën e luftimit të korrupsionit, institucioni kryesor – Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës tani për tani nuk po merr ndonjë ndihmesë teknike serioze pas përfundimit të projektit të BE-së kah fundi i vitit të kaluar, përmes të cilit u ofrua ndihmesa teknike dhe këshillat juridike në fusha të caktuara të aktiviteteve të AKKK-së. Në vjeshtë të vitit 2011, Këshilli i Evropës, përmes programit të tij të ndihmesës teknike, ka ofruar një ekspert për afat të gjatë për AKKK-në në përkrahjen e rishikimit të Strategjisë së tyre kundër korrupsionit dhe në hartimin e Planit të ri të veprimit, së bashku me mekanizmat për matjen e suksesit në punë. Duket se një projekt gjithëpërfshirës në fushën kundër korrupsionit që do të mbulon një vistër të gjerë sektorësh dhe temash planifikohet të fillohet nga UNDP-ja në fund të vitit 2012.

Në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe të luftimit të financimit të terrorizimit, institucionet e Kosovës aktualisht janë duke marrë ndihmesë të zgjeruar teknike nga Departamenti i ShBA i Thesarit- Zyra për Asistencë Teknike (ZAT), posaçërisht përmes Këshilltarit Rezident, të vendosur në Prishtinë. Programi përfshinë trajnimet dhe konsultimet e një numri të madh të agjencive, të përfshira në sistemin e luftimit të pastrimit të parave dhe të luftimit të financimit të terrorizimit, duke përfshirë NjIf-in dhe autoritetet për zbatimin e ligjit, përkthazi me aktivitetet e tyre operacionale dhe rregullimin institucional, si dhe me ndihmesën në hartimin e legjislacionit. Në vitin 2011, këshilltari rezident i ZNT-së ka ndihmuar NjIf/FIC-in në krijimin e një grupi joformal punues të përbërë prej agjencive të ndryshme me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së Ligjit për luftimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit me 40+9 rekomandime të FATF-së. Një numër i caktuar dhe gjithëpërfshirës i ndryshimeve në Ligjin për luftimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizimit janë hartuar si rezultat i këtij procesi, dhe i janë dorëzuar ministrit të

³⁰ <http://fic-ks.org/>; www.eulex-kosovo.eu/en/news/000237.php.

³¹ Me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Kroacinë, Slloveninë, San Marino dhe Turqi

³² Ekzistojnë gjithsej 74 institucione, duke përfshirë 8 banka, 11 kompani sigurimesh, 2 fonde pensionale dhe 15 institucione mikrofinanciare.

³³ http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf

Financave të Kosovës në fillim të vitit 2012, i cili, siç parashihet, do t'ia parashtrojë propozimin zyrtar Kuvendit në pjesën e dytë të vitit 2012.

3.4 Nevojat e tanishme

Gjatë aktiviteteve të fillimit dhe takimeve me homologët dhe përfituesit kryesorë, nevojat e tanishme në fushat e luftimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizimit në përgjithësi janë vërtetuar të jenë si në vijim:

- | | |
|-----------|---|
| Nevoja 1: | Përkufizimi kompetencave për rregullimin dhe zbatimin e aktiviteteve kundër korrupsionit; |
| Nevoja 2: | Fuqizimi i bashkërendimit lidhur me zbatimin e Strategjisë kundër korrupsionit dhe Planit të veprimit, inkurajimi i elaborimit të Strategjisë dhe i bashkëpunimit ndërmjet agjencive në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizimit, posaçërisht lidhur me zbatimin e ligjit; |
| Nevoja 3: | Ngritja e kapaciteteve në fushat kryesore, siç janë prokuroria, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, ndihmesa e ndërsjellë juridike dhe mbikëqyrja; |
| Nevoja 4: | Përmirësimi i mëtejme i legjislacionit në fushat kryesore, siç është Kodi penal, Kodi i procedurës penale, Ligji kundër pastrimit të parave, si dhe aktet e nevojshme nënligjore dhe |
| Nevoja 5: | Sigurimi i disponueshmërisë së të dhënave gjithëpërfshirëse dhe informatave për vlerësimin e rreziqeve dhe të efektshmërisë së masave. |

4 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE/QËLLIMEVE TË PROJEKTIT

4.1 Aktivitetet

Objektivi i përgjithshëm	Dhënia e kontributit për demokracinë dhe sundimin e ligjit përmes parandalimit dhe kontrollit të korrupsionit, të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit në Kosovë.	
Qëllimi i projektit	Fuqizimi i kapaciteteve institucionale për luftimin e korrupsionit, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit në Kosovë në përputhje me standardet evropiane përmes vlerësimit të thuktë dhe rekomandimeve për përmirësimin e reformave kundër krimit ekonomik.	
Rezultati 1	Vlerësimi i masave kundër korrupsionit	
Aktivitetet		
1.1.	Ekzistimi i raporteve të progresit lidhur me nivelin e përputhshmërisë të rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (bazuar në përvojën dhe kriteret e GRECO-s dhe organeve të tjera relevante ndërkombëtare);	Fillimi i procedurave, përmes të cilave do të përkrahet fillimi i vlerësimeve periodike për masat kundër korrupsionit: përgatitja dhe finalizimi i termeve të referencës dhe i pyetësorëve në bashkërendim dhe konsultim me EULEX-in; përgatitja e matricës së pajtueshmërisë dhe caktimi i prioritetëve lidhur me vlerësimin e korrupsionit. Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC, mëditjet, udhëtimet jashtë vendit, përkthimet me shkrim dhe me gojë, publikimi dhe shpërndarja, shpenzimet e punëtorëve dhe të konferencave. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, hulumtimet studimore.
1.2	Zbatimi i vlerësimeve nga kolegët për masat kundër korrupsionit, duke u bazuar në metodologjinë evropiane të monitorimit.	Organizimi i dy vlerësimeve të njëpasnjëshme (fillestar dhe përfundimtar) për masat kundër korrupsionit, duke përfshirë një raport të progresit, në bashkërendim me EULEX-in; përkrahja e institucioneve të Kosovës në përmirësimin e kapaciteteve të tyre raportuese në përputhje me metodologjinë e vlerësimit për masat kundër korrupsionit/reformat dhe zhvillimi i mekanizmave për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të

		nevojshme për raportim lidhur me masat/reformat kundër korrupsionit.
		Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC (ndërkombëtare dhe vendore), mëditja, udhëtimet jashtë vendit, punëtoritë dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, takimet
1.3	Dhënia e rekomandimeve për fushat rregullative, institucionale dhe të politikave.	Përgatitja dhe dhënia e rekomandimeve, duke u bazuar në vlerësimet, si dhe sigurimi i një kuptueshmërie të unifikuar të reformave të propozuara në bashkërendim me EULEX-in.
		Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC (ndërkombëtare dhe vendore), mëditja, udhëtimet jashtë vendit, punëtoritë dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, takimet
1.4	Publikimi dhe shpërndarja e raporteve të vlerësimit dhe të progresit (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.	Publikimi, përkthimi, shpërndarja dhe vetëdijesimit për raportet e vlerësimit dhe të progresit (duke përfshirë matricën e përputhshmërisë) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.
		Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC (ndërkombëtare dhe vendore), mëditja, udhëtimet jashtë vendit, punëtoritë dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, takimet
Rezultati 2	Vlerësimi për masat kundër pastrimit të parave dhe masat për luftimin e financimit të terrorizimit.	
Aktivitetet		

2.1	Hartimi i raporteve të vlerësimit dhe të progresit për nivelin e përputhshmërisë së rregulloreve dhe praktikave në fuqi me standardet evropiane (duke u bazuar në përvojën dhe kriteret e MONEYVAL-it dhe organeve të tjera relevante ndërkombëtare).	Organizimi i dy vlerësimeve të njëpasnjëshme për masat kundër pastrimit të parave dhe masat për luftimin e financimit të terrorizimit në bashkërendim me EULEX-in; përgatitja e matricës së pajtueshmërisë dhe caktimi i prioritetëve lidhur me vlerësimet për shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizimit. Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC (ndërkombëtare dhe vendore), mëditja, udhëtimet jashtë vendit, punëtoritë dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë, si dhe shpenzimet e publikimit dhe të shpërndarjes. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, takimet
2.2	Realizimi i vlerësimeve nga kolegët lidhur me masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit, duke u bazuar në metodologjinë evropiane të monitorimit.	Përkrahja për institucionet e Kosovës në përmirësimin e kapaciteteve të tyre raportuese në përputhje me metodologjinë e vlerësimit, si dhe në zhvillimin e mekanizmave për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për raportim për reformat në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit. Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC, mëditjet, udhëtimet jashtë vendit, punëtoritë dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, takimet.
2.3	Dhënia e rekomandimeve për fushat rregullative, institucionale dhe të politikave.	Përgatitja dhe dhënia e rekomandimeve, duke u bazuar në vlerësime. Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC, mëditjet, udhëtimet jashtë vendit, punëtoritë dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë, si dhe të publikimit e shpërndarjes. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, takimet.

2.4	Publikimi dhe shpërndarja e raporteve të vlerësimit dhe të progresit (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.	Publikimi, përkthimi, shpërndarja dhe vetëdijesimi për raportet e vlerësimit dhe të progresit (duke përfshirë matricën e pajtueshmërisë) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Shpenzimet: pagesa e ekspertit kryesor, STC (ndërkombëtare dhe vendore), mëditjet, udhëtimet jashtë vendit, punëtoritë dhe shpenzimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë, si dhe të publikimit e shpërndarjes. Inputet: këshillat ditore të ekspertit kryesor, konsultimet STC, mendimet juridike, takimet, vizitat studimore.
-----	--	---

4.2 Inputet

Projekti do të jep inputet si në vijim, duke përkrahur dhe ndihmuar njëherazi arritjen e rezultateve të pritura në përputhje me planin e miratuar të punës dhe me nevojat e reja, ashtu siç janë dakorduar në mbledhjet e Komisionit drejtues:

Studimet hulumtuese;
 Vizitat vlerësuese në terren;
 Tryezat e rrumbullakëta dhe seminarët;
 Përkthimet/publikimet;
 Mbulimi nga mediet dhe veprimet e transparencës.

4.3 Rezultatet

Rezultatet në kuadër të dy komponentëve përfshijnë:

Termet e referencës për metodologjinë dhe procedurën e vlerësimit;
 Raportet e vlerësimit dhe të progresit, si dhe matricat e pajtueshmërisë;
 Trajnimet (sesionet informuese) për metodologjinë e vlerësimit ndërkombëtar;
 Punëtoritë (grupet e vogla të punës, të identifikuara si metodologji e punës/intervistimit gjatë vizitave në terren;
 Konferencat (diskutimet në seanca plenare për rezultatet e vlerësimeve).

5 AKTIVITETET E FILLIMIT

5.1 Përmbledhje e veprimeve

Aktivitetet vijuese janë realizuar gjatë fazës së fillimit të projektit dhe rrjedhimisht para fillimit të aktiviteve të projektit (1 shkurt 2012 – 15 gusht 2012):

Përshkrimi i aktiviteve të fazës së fillimit	Gjendja (që nga 30 prill 2012)
Punësimi i ekipit të projektit (Strasbourg dhe Prishtinë): Këshilltari/menaxheri i projektit (Prishtinë - 100% me orar të plotë) – i punësuar dhe operacional Zyrtarin vendor të projektit (Prishtinë, me orar të plotë): I punësuar dhe funksional Zyrtar i projektit (Strasbourg – gjysmë orari): I Punësuar dhe operacional; Ndihmësi i projektit (Strasbourg – me orar të plotë)	I përfunduar
Angazhimi i 6 ekspertëve (për komponentën kundër korrupsionit dhe komponentën e LPP/FT) për periudhën e kohëzgjatjes së projektit.	I përfunduar
Ndarja dhe sistemimi i zyrës së projektit	I përfunduar
Aktivitetet fillestare (Faza I: 14-17 shkurt 2012): Njoftim me projektin i institucioneve homologe/përfutuese në hartimin e termeve të referencës (metodologjia e vlerësimit)	Të përfunduara
Aktivitetet fillestare (Faza II: 26-28 mars 2012): Rishikimi i termeve të referencës (metodologjisë së vlerësimit); dhe diskutimi i pyetësorëve të vlerësimit lidhur me LK dhe LPP/FT.	Të përfunduara
Fillimi i projektit – Faza III (25-26 prill 2012)	I përfunduar
Takimet Shpjeguese me autoritetet e Kosovës mbi pyetësorët e vlerësimit (10-12 korrik 2012)	Të përfunduara
Përgatitja dhe dorëzimi i draft raportit fillestar	E përfunduar

5.1 Krijimi i ekipit të projektit/rekrutimi

Çdo pozitë e ekipës në Strasbourg dhe Prishtinë është duke u plotësuar me shpallje të punës sipas rregullave dhe procedurave dhe afateve të politikave të Burimeve Njerëzore dhe procedurave të tjera të Këshillit të Evropës. Në lidhje me këtë, gjatë muajit të shkurtit 2012, është rekrutuar në Prishtinë Zyrtari Vendor i Projektit (ZVP). Punësimi i Këshilltarit të Projektit është bërë në korrik 2012. Këshilltari i Projektit është vendosur në Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe do të këshillojë dhe monitoroj implementimin e projektit në baza ditore.

Të gjithë aplikuesit dhe kandidatët janë futur në listën e ngushtë, dhe më pastaj janë përzgjedhur në bazë të kualifikimeve, përvojës dhe aftësive të tyre, si dhe në bazë të performancës gjatë intervistës. Përveç kësaj, performanca dhe vlerësimet e punësimit paraprak janë vërtetuar përmes kontrolleve referuese.

Ekipi i projektit i Prishtinës, i përbërë prej dy anëtarëve (Këshilltari i projektit dhe Zyrtari vendor i projektit) do t'i raportojnë drejtpërdrejt Njësisë kundër krimeve ekonomike në Departamentin e veprimeve kundër krimit lidhur me çështjet thelbësore dhe ato të ndërlidhura me zbatimin e planit të punës, të cilët janë të përkrahur nga zyrtari i projektit dhe nga ndihmësi i projektit në Strasbourg. Puna e tyre e përditshme administrative në Prishtinë do të mbikëqyrret dhe përkrahët nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

5.2 Zyra/mjediset e projektit

Zyra e projektit gjendet në kuadër të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, e cila ofron infrastrukturën teknike dhe të TI-së që i nevojitet. Adresa dhe të dhënat relevante për projektin janë si në vijim:

Projekti: PKEK-Kosovë
Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë
Rr. Bedri Pejani 3, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: + 381 38 243 749; Lok:105; Fax: + 381 38 243 752
luljeta.plakolli@coe.int

5.3 Aktivitetet fillestare – Faza I (14-16 shkurt 2012)

Ekipi i misionit të Këshillit të Evropës – i përbërë nga znj. Ardita Abdiu, udhëheqëse e Njesisë kundër krimeve ekonomike, znj. Luljeta Plakolli-Kasumi, zyrtare vendore e projektit dhe z. Tilman Hoppe, ekspert i Këshillit të Evropës filluan aktivitetet nismëtare të PKEK-Kosovë (gjegjësisht fazën e I-rë) gjatë javës prej 14-16 shkurt 2012 (shih shtojcën IV-Programi i misionit).

Gjatë këtij misioni, janë organizuar takime dypalëshe me të gjitha palët dhe përfituesit e projektit, si dhe me organizatat ndërkombëtare me qëllim të përshkrimit të projektit në hollësi. Më konkretisht, gjatë çdo takimi dypalësh është shpjeguar dhe janë këmbyer informata për kohëzgjatjen e projektit, ciklet e tij, objektivin, qëllimin, rezultatet e pritura dhe për komponentët e tij, duke përfshirë angazhimin e burimeve administrative dhe njerëzore në zbatimin e projektit, si dhe metodologjinë e zbatimit të dy vlerësimeve (komponent të projektit). Këto takime edhe njëherë kanë vërtetuar se ky projekt do të mirëpritet dhe përkrahet nga partnerë të ndryshëm në Kosovë. Ideja e projektit dhe lidhja e tij me KE-në, si dhe metodologjia e tij për mekanizmat e monitorimit është lavdëruar nga organizatat ndërkombëtare (EULEX, UNMIK, OSBE etj.), si dhe është konsideruar jo vetëm si një instrument i vlefshëm për plotësimin e objektivave të përbashkëta në Kosovë, por edhe si aktivitetet i qëndrueshëm, përmes të cilit do të jepet ndihmesa në përfshirjen e rezultateve, drejt të cilave këto organizata janë duke punuar.

Më 16 shkurt 2012, është mbajtur punëtorja fillestare në praninë e përfaqësuesve të takimeve të mëparshme dypalëshe, por edhe të përfaqësuesve të tjerë nga institucionet e ndryshme partnere, në të cilën u mbledhën rreth 30 pjesëmarrës. Kjo punëtori dha mundësinë e prezantimit në mënyrë të unifikuar të hollësive dhe informatave të nevojshme për projektin. Më konkretisht, metodologjinë e realizimit të vlerësimit të komponentit 1- Korrupsionit, dhe komponentit 2 –Pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit. Po ashtu, dha mundësinë e dhënies së prezantimit për metodologjinë që do të aplikohet për secilin komponent (e cila do të bazohet në metodologjinë dhe pyetësin e përdorur në vlerësimet e GRECO dhe MONEYVAL), por do të jetë e përshtatur për Kosovën dhe statusin/gjendjen neutrale të saj, duke marrë parasysh se ky proces do të udhëhiqet si një proces vlerësimi dhe jo vlerësimi të ndërsjellë të mekanizmit të monitorimit.

Punëtorja fillestare është hapur nga Zyra e KE-së në Prishtinë dhe Zyra e BE-së në Kosovë. Udhëheqësi i Zyrës së KE-së në Prishtinë ka kryesuar dhe moderuar punëtorinë. Sekretaria e Njesisë kundër krimit ekonomik dhe eksperti z. Tilman Hoppe në këtë punëtori kanë shpalosur aspektet teknike lidhur me projektin, Termet e referencës për procesin e vlerësimit të të dy komponentëve dhe kategoritë e raporteve të vlerësimit (ciklet e tyre), publicitetin e raportit dhe klauzolat e tij për konfidencialitetin, si dhe afatet. Përfaqësuesit e OSBE-së, Zyrës së BE-së në Prishtinë, Zyrës së KE-së në Prishtinë, Agjencisë Kundër Korrupsionit të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës, Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe të Policisë së EULEX-it dhanë kontributin dhe komentet e tyre në përmirësimin dhe qartësimin e Propozimtermeve të referencës. Si rezultat i kësaj, këto kontribute dhe komente tanimë janë përfshirë dhe trajtojnë çështjet e ngritura nga përfaqësuesit e lartpërmendur.

5.4 Aktivitetet fillestare – faza II (28-29 mars 2012)

Më 28 dhe 29 mars 2012, ekipi i misionit të Këshillit të Evropës – i përbërë nga znj. Ardita Abdiu, udhëheqëse e Njesisë kundër krimeve ekonomike dhe znj. Luljeta Plakolli-Kasumi, zyrtare vendore e projektit, kanë realizuar një numër takimesh me palët me interes, më konkretisht, me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Agjencinë Kundër Korrupsionit të Kosovës (AKKK), Qendrën për Inteligjencë Financiare (FIC), Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, si dhe me Zyrën e BE-së në Prishtinë (shih shtojcën V – Programi i Misionit).

Takimet kanë qenë të parapara për rishikimin dhe finalizimin e Termeve të referencës dhe, çka është më e rëndësishmja, për diskutimin e përmbytjes së pyetësorëve që do të përdoren për vlerësim, të përgatitur nga Sekretaria e Këshillit të Evropës, si dhe për shpjegimin e rolit kyç bashkërendues të AKKK-së dhe FIC-it, duke përfshirë edhe ndarjen e përgjegjësiave për rubrika të ndryshme të pyetësorëve në mesin e agjencive të përfshira në këtë proces. Takimet gjithashtu u përqendruan në modalitetet dhe në përgatitjen e konferencës nismëtare, përmes së cilës do të sigurohet përkrahja nga nivelet e larta politike dhe dukshmëria e projektit të PKEK-së.

Draft Termit e Referencës për vlerësim janë diskutuar përsëri në takimet me Zyrën e BE-së në Prishtinë, e cila pritet t'i miratojë ato si tekst përfundimtar pas miratimit nga institucionet kryesore përfituese. Pas këtyre takimeve, janë përfshirë ndryshimet e duhura në Propozimtermet e referencës.

5.5 Fillimi i projektit – faza III (25-26 prill 2012)

Para konferencës për fillimin e projektit janë mbajtur një numër takimesh me palët kryesore me interes të projektit, posaçërisht me FIC-in, AKKK-në dhe me Zyrën e BE-së në Prishtinë për të diskutuar formatin e konferencës, renditjen e folësve, si dhe hapat e aktivitetet e mëtejshme të projektit (shih shtojcën VI – Programi i Misionit).

Sa i përket bashkërendimit shtesë me ofruesit e tjerë të ndihmesës teknike në fushat e njëjta, ekipi i projektit (i përbërë nga administruesi i KE-së, zyrtari i projektit, zyrtarja vendore e projektit dhe eksperti i BE-së për çështjet kundër korrupsionit) mbajtën takim me këshilltarin rezident të Zyrës për Ndihmesë Teknike (ZNT) të Thesarit të ShBA-ve me qëllim të shqyrtimit të fushave të mundshme për bashkëpunim dhe të shmangies së çfarëdo dyfishimi të punëve gjatë zbatimit të projektit (gjithashtu shih pjesën 3 më lartë). Në takim u theksua nevoja e sigurimit të bashkëpunimit të ngushtë, posaçërisht duke marrë parasysh punën paraprake që ka bërë ZNT-ja e Thesarit Amerikan në vlerësimin e kornizës së Kosovës për luftimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit kundruall standardeve të FATF-së, dhe rrjedhimisht, hartimin e një numri amendamentesh legislative për trajtimin e mangësive të identifikuar. Për të siguruar që produkti përfundimtar i paraparë nga projektit i PKEK-së (vlerësimet, raportet dhe rekomandimet) të jenë të azhurnuara dhe relevante, duhet të bëhen përpjekje që këto konkluda dhe propozimdokumente legislative të analizohen dhe të merren parasysh nga ekipet e ekspertëve, si dhe të monitorohet më tej përparimi i ndihmesës së dhënë nga ZNT-ja e Thesarit Amerikan. Ngjashëm me këtë, në takimin me përfaqësuesin e UNDP-së u identifikua mundësia e orientimit të duhur të rezultateve të ciklit të parët të vlerësimit, i cili do të përfundojë deri në fund të vitit 2012, dhe të cilat do të shfrytëzohen nga projekti i planifikuar i UNDP-së kundër korrupsionit që ka për qëllim identifikimin dhe eliminimin e mangësive në kornizën më të gjerë kundër korrupsionit në Kosovë.

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PKEK) zyrtarisht ka filluar më 26 prill 2012 gjatë konferencës nismëtare në Prishtinë (shih shtojcën VII – Rendi i ditës i konferencës nismëtare). Në konferencën nismëtare kanë marrë pjesë mbi 100 përfaqësues të ministrive dhe agjencive relevante, të organizatave ndërkombëtare, sektorit privat dhe të shoqërisë civile. Konferenca nismëtare është hapur nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuqi, ministrja e Integrimeve Evropiane, Vlora Çitaku, z. Samuel Zhbogar, PSBE/Udhëheqës i Zyrës së BE-së në Prishtinë dhe nga udhëheqësi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, Tim Kartrajt (Tim Cartwright). Prezantimi i procedurës së vlerësimit, duke përfshirë fazat kryesore të projektit, si dhe përmbledhja e përgjithshme e standardeve ndërkombëtare kundër korrupsionit dhe kundër pastrimit të parave, si dhe të luftimit të financimit të terrorizmit është bërë para një audience të gjerë të pranishme në konferencë, të cilët vinin nga agjenci të ndryshme. Gjatë prezantimit, po ashtu është theksuar roli i veçantë i dy koordinatorëve vendorë – AKKK-së dhe FIC/NjIF-së, si dhe është nënvizuar rrjedha e komunikimeve në mesin e akterëve të ndryshëm të përfshirë në plotësimin e pyetësorëve. Më pastaj janë bërë prezantimet e hollësishme të pyetësorëve kundër korrupsionit, kundër pastrimit të parave dhe për luftimin e financimit të terrorizmit, duke përfshirë pjesët dhe temat kryesore, si dhe dispozitat specifike. Prania e autoriteteve të nivelit të lartë, si dhe pjesëmarrja e ministrive dhe agjencive të shumta në konferencën nismëtare është faktor kryesor në sigurimin e përkushtimit të nevojshëm afatgjatë ndaj procesit të vlerësimit dhe rezultateve të tij.

5.6 Takimet Shpjeguese mbi Pyetësorët e Vlerësimit (10-12 korrik 2012)

Një varg i takimeve shpjeguese janë mbajtur nga 10-12 korrik 2012, në mes të ekipit të Projektit, ekspertëve ndërkombëtar dhe autoriteteve të Kosovës. Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë prezantimi i aspekteve thelbësore të pyetësorëve për luftimin e korrupsionit (LK) dhe pastrimit të parave/financimit të terrorizmit (PP/FT) të cilat do të përdoren në vlerësimin e Kosovës për përputhshmërinë me standardet relevante ndërkombëtare të bazuara në metodologjitë e MONEYVAL dhe GRECO. Agjenda për Takimet Shpjeguese është strukturuar për ta lehtësuar dialogun me autoritetet, dhe çdo segment i agjendës ka qenë i synuar tek audiencia specifike që ka përfshirë një listë të paracaktuar të institucioneve të Kosovës. Prezantimet e ekspertëve kanë qenë të detajuara dhe kanë adresuar çështje nga pjesët përkatëse të pyetësorëve.

Takimet Shpjeguese kanë filluar me një prezantim të shkurtër të procesit të vlerësimit dhe dispozitat e përgjithshme në pyetësorët e vlerësimit. Njëjtë për të dy komponentat, janë shpjeguar dhe diskutuar me pjesëmarrësit çështjet e përgjigjesë penale të korporatave, konfiskimin, ngrirjen, dhe marrjen e pasurisë së fituar nga krimi, autoritetet e zbatimit të ligjit, procedurat e hetimit dhe penale, dhe çështjet që ndërlidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar të zbatimit të ligjit/NjIF dhe asistencën reciproke ligjore/ekstradimin. Çështjet specifike në lidhje me komponentën KK të cilat janë adresuar gjatë këtyre takimeve shpjeguese kanë qenë të ndërlidhura me financimin e partive politike dhe fushatat zgjedhore, shkeljet dhe sanksionet për korrupsion, parimet themelore dhe masat e parandalimit të korrupsionit në polici, gjyqësor, prokurori, administratë publike, kuvend dhe prokurim publik. Pyetjet për PPP/LFT kanë qenë të ndërlidhura me penalizimin e pastrimit të parave, dhe financimin e terrorizmit, organizatat jo-profitabile, deklaramin dhe shpalesjen ndër-kufitare,

Njësitin e Inteligjencës Financiare, personat juridik-qasjen në informacionin e pronësisë përfituese dhe kontrollin, teknikat moderne të sigurimit të transaksioneve, mbajtjen e shënimeve, rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, hetimin e konsumatorëve, personat e ekspozuar politikisht (PEP), ligjet e sekreteve, raportimin e transaksioneve të dyshimta në lidhje me PP dhe FT, bankat shell, mbikqyrjen dhe monitorimin e vazhdueshëm dhe hyrjen në treg, mbikqyrësit, sanksionet dhe shërbimet për transfer të parave apo vlerave.

Kopjet e pyetësorëve përkatës dhe përmbledhja e standardeve ndërkombëtare dhe Evropiane KK dhe KPP/LFT u janë shpërndarë pjesëmarrësve. Takimet Shpjeguese janë vijuar nga institucionet relevante, siç janë dy autoritetet koordinuese për çdo komponentë të vlerësimit si p.sh. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), dhe Njësi i Inteligjencës Financiare (NjIF), autoriteti i gjithmbarshëm koordinues- Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, si dhe ministritë relevante, gjyqësori, prokuroria, policia, doganat, agjencitë e pavarura, dhe Banka Qëndrore (Lista e Pjesëmarrësve).

5.7 Takimet Bilaterale me Institucionet e Kosovës

Këshilltari i Projektit PKEK ka mbajtur gjatë muajit korrik dhe gusht 2012 një numër të takimeve ndërlidhëse dhe paravlerësuese me institucionet si në vijim:

- Njësi i Inteligjencës Financiare (NjIF);
- Departamenti i Thesarit i ShBA- Zyra për Asistencë Teknike (ZAT);
- Agjencioni Kundër Korrupsionit (AKK);
- Zyra e Bashkimit Evropian në Prishtinë, Njësi i Sundimit të Ligjit;
- Ministria e Administratës Publike, Departamenti për Regjistrimin dhe Ndërlidhjen me OJQ-të;
- Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP);
- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP);
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPR);
- Banka Qëndrore e Kosovës (BQK);
- Organi i Rishikimit të Prokurimit Publik (ORPP).

Shpjegimet e roleve përkatëse dhe përfshirja e institucioneve në fjalë gjatë fazave vijuese të vlerësimit, nevoja për të emëruar pika të qëndrueshme kontakti/ekspert për dhënie të informacioneve dhe përkrahje/informacione të mëtutjeshme janë dhënë dhe diskutuar gjatë takimeve.

Ndërlidhja dhe takimet e mëtutjeshme me akterët kryesor janë planifikuar të mbahen para dorëzimit të pyetësorëve tek autoritetet vendore (në mes tjerash, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Menaxhimin e Pasurisë së Marrë apo Konfiskuar, Departamentin e Administratës së Shërbimit Civil, dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë.

6 DUKSHMËRIA/MBULIMI MEDIAL

6.1 Faqja e internetit e PKEK-së

Lajmet për projektin, ngjarjet vijuese dhe rezultatet do të raportohen në faqen e internetit kundër krimit ekonomik të Këshillit të Evropës të (www.coe.int/corruption), një pjesë e të cilës ekskluzivisht i është dedikuar projektit të PKEK-së: http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/Projects/PECK-Kos/PECK-default_en.asp.

Në faqen e internetit do të raportohen rregullisht të gjitha aktivitetet, rezultatet dhe lajmet për projektin. Kjo faqe e zyrtare e internetit e Këshillit të Evropës do të ketë vegëzat (linçet) për faqet e tjera relevante të internetit në Kosovë dhe në botë.

6.2 Dukshmëria e BE-së

Përmes projektit do të sigurohet dukshmëria e kontributit të BE-së në të gjitha fazat e aktivitetit të tij. Këshilli i Evropës do të marr masat e nevojshme për të publikuar faktin se financimi i projektit bëhet përmes marrëveshjes me Bashkimin Evropian. Të gjitha raportimet dhe informatat e përdorura dhe të shpërndara do të vërtetojnë se janë kryer veprimet përmes “financimit nga Bashkimi Evropian”, duke e paraqitur në mënyrë të duhur edhe logon e Bashkimit Evropian.

6.3 Mohim

Të gjitha publikimet do të kenë mohimin vijues: “Ky dokument (*raport/publikim, etj*) është hartuar përmes financimit kryesor nga Bashkimi Evropian dhe nga Këshilli i Evropës. Përmbajtja e këtij dokumenti në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës”.

6.4 Publikimet

Në kuadër të projektit do të hartohen raporte për t’ia dhënë informatat e fundit Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë lidhur me të gjeturat dhe përparimin e zbatimit të projektit. Gjatë realizimit të projektit do të shfrytëzohen broshura dhe fletëpalosje, si dhe kopjet e tyre do të jenë në dispozicion për raportim. Siç është paraparë në Kushtet e përgjithshme të Marrëveshjes së projektit, “Çdo [rezultat i projektit] publikim dhe komunikatë për shtyp do t’i komunikohet autoritetit kontraktues [Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë] me rastin e nxjerrjes së saj nga shtypi”. Nëse bëhet çfarëdo publikimi, aty do të ceket kontributi financiar i BE-së dhe do të figuron Mohimi i lartpërmendur. Këto publikime po ashtu do të jenë në dispozicion për qytetarët.

7 BUXHETI DHE KONTRIBUTET

Kostoja e përgjithshme e projektit për periudhën 30 mujore gjithsej është 1,200.000 euro. Kjo shumë përfshinë:

1.000.000 euro kontribut financiar nga BE-ja dhe
200.000 euro kontribut financiar nga KE-ja.

Pas nënshkrimit të kontratës (janar 2012), dhe pas parashtrimit të kërkesës së parë për pagesë (të datës 9 janar 2012, Këshilli i Evropës ka pranuar shumën prej **397,410.10 euro** në emër të kështit të parë në përputhje me nenin 4(2) të Kushteve të posaçme (buxheti i projektit të PKEK-së është bashkëngjitur – shih shtojcën IX).

8 HAPAT E ARDHSHEM DHE PËRFUNDIMET

8.1 Hapat e ardhshëm

Draft plani i punës së bashku me **raportin fillestar** do të shqyrtohen dhe diskutohen në takimin e parë të Këshillit drejtues, që orientimisht është caktuar për 12 shtator 2012, i cili do të mbahet pas konsultimeve të brendshme mes KE-së dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë.

8.2 Ndikimi afatgjatë i projektit

Projekti rrjedh nga nevoja e Kosovës për një proces gjithëpërfshirës dhe të strukturuar të vlerësimit. Derisa reformat lidhur me korrupsionin dhe pastrimin e parave janë në zbatim e sipër që disa vite me radhë, nuk ka ekzistuar një proces i strukturuar dhe afatgjatë për vlerësimin e progresit dhe ndikimit të tyre. Për herë të parë, një program posaçërisht i dizajnuar do të ketë si qëllim strategjinë dhe resurset për realizimin e vlerësimit periodik dhe të thukhtë në Kosovë për çështjet që kanë të bëjnë me krimin ekonomik dhe, më konkretisht: për korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Vlerësimet do të përfshijnë fushat institucionale, të politikave juridike dhe të resurseve, të ndara në tema të veçanta, kryesisht të modeluara sipas mekanizmave të Këshillit të Evropës (GRECO dhe MONEYVAL). Një përpjekje e bashkërenduar e BE-së dhe e KE-së, e bazuar në përvojën e projekteve të shumta të përbashkëta në këtë fushë është një qasje e duhur për sigurimin e zbatimit të standardeve dhe praktikave evropiane në Kosovë. Një përpjekje e tillë do t'i kontribuonte reformave koherente kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave në Kosovë, që do të shkonte edhe në dobi të EULEX-it në Kosovë, duke i bërë kështu rezultatet e reformave më të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet evropiane. Gjithashtu, që nga fillimi, por edhe gjatë zbatimit të tij, projekti do të krijojë ndërlidhje, bashkërendim dhe do të kërkojë përkrahje nga projektet e ndërlidhura që janë në realizim e sipër nga organizatat e tjera në Kosovë.

8.3 Komisioni drejtues dhe koordinatorët e projektit

Në bazë të përshkrimit të projektit dhe të takimeve të mbajtura me palët kryesore, autoritetet e Kosovës kanë konfirmuar se Zyra për Qeverisje të Mirë, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore (ZQM) do ta caktojë koordinatorin e projektit për të siguruar rrjedhë të duhur të informatave dhe bashkëpunim të të gjitha institucioneve relevante. Gjithashtu, Agjencia Kundër Korrupsioni e Kosovës (AKKK) dhe Njësi për Inteligjencë Financiare (NjIF) do të kërkojnë që të caktojnë dy zyrtarë vendorë ndërlidhës që janë zyrtarë të lartë në institucionet përkatëse (nga fusha e luftimit të korrupsionit dhe të pastrimit të parave). Këta zyrtarë do të funksionojë si palë kryesore përgjegjëse për koordinimin e aktiviteteve të projektit në emër të institucioneve/autoriteteve të Kosovës. Projekti do ta ketë Komisionin e vet drejtues, i cili do të përbëhet prej:

Zyrës për Qeverisje të mirë nga Zyra e kryeministrit;
Agjencisë Kundër Korrupsionit të Kosovës;
Qendrës për inteligjencë financiare/Njësisë për inteligjencë financiare;
Ministritë së Drejtësisë;
Ministritë së Financave;
Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe
Njësisë kundër krimit ekonomik të Këshillit të Evropës/Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Takimet e Komisionit drejtues do të organizohen çdo 6 muaj, ku sipas nevojës do të marrin pjesë edhe autoritetet e tjera relevante që ndërlidhen me rezultatet dhe aktivitetet e projektit. Komisioni drejtues do të merr vendime strategjike, do të mbikëqyrë zbatimin e duhur të projektit, si dhe do të bashkëdrejtohet nga përfaqësuesi i Zyrës së BE-së dhe KE-së. Termat e referencës së Komisionit drejtues i janë bashkëngjitur këtij raport, dhe do të miratohen në mbledhjen e parë të Komisionit drejtues.

8.4 Rreziqet e mundshme

Gjatë muajve qershor-gusht 2012, aktivitetet e Projektit nuk kanë arritur progres për arsye përtej kontrollit të ekipës së Projektit dhe Organizatës. Ekipa e projektit e ka pasur të pamundur mbajtjen e takimit të Këshillit Drejtues për shkak të diskutimeve të vazhdueshme në mes të Organizatës dhe Autoritetit Kontraktues në lidhje me përmbajtjen e fusnotës që duhet përdorur kur t'i bëhet referimi "Kosovës" në dokumentet e Projekteve të Përbashkëta me BE-në. Përkundër ndërrimit në orar, ekipa e Projektit do të bëjë të pamundurën që t'i zhvillojë aktivitetet e Projektit në pajtim me kornizën e përcaktuar nga Përshkrimi i Aktiviteteve.

Rreziku politikë i përfshirë në këtë projekt nuk konsiderohet të jetë i lartë në kohën e raportimit. Megjithatë, këshillohet të përcjellën rreziqet si në vijim, të identifikuara në Përshkrimin e Aktiviteteve të Projektit:

- Mungesa e stabilitetit politik

Zgjedhjet presidenciale në Kosovë janë mbajtur në prill të vitit 2011, ndërsa zgjedhjet parlamentare në dhjetor 2010. Nëse nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme, projekti do të mund të vazhdojë së zbatuari deri në vitin 2014 pa ndryshim të administratës. Përveç të tjerash, jostabiliteti politik nuk ka gjasa të ndikojë në rezultatet e projektit. Nëse kjo ndodh, atëherë mund të vonohen disa procese në kuadër të projektit apo ta vështirësojnë zbatimin tij, por kjo do të jetë brenda fleksibilitetit të paraparë në projekt, dhe përmes një menaxhimi profesional, ekipi i projektit do të jetë në gjendje të ballafaqohet me çfarëdo ndikimi negativ. Përmes projektit po trajtohet një nga prioritetet kryesore të politikave të Kosovës në rrugën e saj drejt standardeve evropiane, dhe garanton se çfarëdo efekti negativ do të jetë vetëm i natyrës së përkohshme dhe do të jetë i menaxhueshëm.

- Mungesa e bashkërendimit dhe e qasjes bashkëpunuese nga palët me interes

Përvoja nga projektet e mëparshme na mundëson perceptimin e rrezikut si të moderuar dhe me pak gjasa për të parandaluar projektin nga arritja e rezultateve. Bashkëpunimi i palëve me interes në kuadër të projektit ka qenë i mirë. Procedura dhe struktura e qartë e projektit dhe përgjegjësia fokale e AKKK-së dhe FIC-it, si dhe e ZQM-së do të siguron qëndrueshmërinë e procesit të bashkëpunimit. Në rast se ndonjë institucion shtetëror tregon mungesë të veprimit të bashkërenduar në kuadër të projektit, një ndërhyrje e Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) nga Zyra e Kryeministrit dhe/apo e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë do të duhej të çonte në bashkëpunim të duhur.

- Mungesa e burimeve financiare nga ana e përfituesve për konsolidimin e të arriturave të projektit

Projekti do të përqendrohet në vlerësimin e reformave të nevojshme legislative, të politikave dhe institucionale, si dhe në identifikimin e nevojave për aftësime dhe aty ku ngritja e kapaciteteve kërkon përmirësime. Andaj, jo të gjitha rezultatet e pritura kërkojnë investime substanciale nga përfituesit, por më shumë kërkojnë ruajtjen e burimeve të qëndrueshme buxhetore që i janë ndarë institucioneve përgjegjëse për punën në kuadër të reformave të përmirësuara të politikave institucionale dhe atyre legislative. Për më tepër, të gjitha institucionet shtetërore që bashkëpunojnë me projekte dhe përfitojnë nga to tanimë janë themeluar dhe janë funksionale.

8.5 Përfundimet

Faza fillestare e projektit është dëshmuar të jetë realizuar në mënyrë të efektshme që nga fillimi i saj, dhe është ardhur në përfundim se tre muajt e fundit kanë qenë kohë e mjaftueshme që projekti të fillojë veprimet e veta kryesore, duke marrë parasysh se marrëveshja për projektin është nënshkruar në janar të vitit 2012 dhe se vet projekti ka filluar në shkurt të vitit 2012. Vonesa në punësimin e menaxherit/këshilltarit të projektit nuk ka pasur ndonjë ndikim negativ në zbatimin e përgjithshëm të fazës fillestare, duke marrë parasysh faktin se një punonjës i KE-së ka vepruar përkohësisht si zëvendësim deri në finalizimin e procesit të rekrutimit. Pozita e menaxherit/këshilltarit të projektit do të jetë thelbësore pasi të ketë filluar procesi i vlerësimit në kuadër të dy komponentëve, i cili do të kërkon monitorim të përditshëm dhe aktiviteteve pasuese me ministritë dhe agjencitë, si dhe me palët e tjera me interes në Kosovë.

Që nga ditët e para të nënshkrimit të projektit, bashkëpunimi dhe shpirti ekipor i demonstruar nga palët e projektit ka qenë shumë i frytshëm dhe në nivel të pritur. Ky është një fillim mjaft premtues, ku gatishmëria për bashkëpunim dhe për realizim të reformave të rëndësishme është bërë e qartë dhe është manifestuar në disa raste nga institucionet e Kosovës.

Shtojca I:	Termet e referencës për procedurën e vlerësimit
Shtojca II:	Plani i punës së aktiviteteve
Shtojca III:	Termet e referencës të Komisionit drejtues të projektit
Shtojca IV:	Programi i aktiviteteve fillestare (Faza I), 14-16 shkurt 2012
Shtojca V:	Programi i aktiviteteve fillestare (Faza II), 28-29 mars 2012
Shtojca VI:	Rendi i ditës për takimet përgatitore të konferencës nismëtare (Faza III), 25 prill 2012
Shtojca VII:	Rendi i ditës së konferencës nismëtare të Projektit të PKEK-së (Faza III), 26 prill 2012
Shtojca VIII:	Agjenda e Takimeve Shpjeguese mbi Pyetësorët e vlerësimit, 10-12, 2012
Shtojca IX:	Buxheti i veprimit
Shtojca X:	Lista e ekspertëve afatshkurtër për projektin e PKEK-së
Shtojca XI:	Orari i vlerësimit: datat kyçe dhe afatet (cikli i parë i vlerësimit)